



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 4. 5 të Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3.1 Rregullës Zgjedhore nr.15/2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parkohshme, si dhe bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr.09/2021 i datës 07.01.2021, për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 07 janar 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

Vendim

Për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës

- I. Miratohet vendimi për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 14 shkurt 2021.
- II. Afatet kohore për zbatimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore që ndërlidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, i referohen afatit prej 39 (tridhjetë e nëntë) ditë, si në vijim:
 - a) Afati për krijimin e Listës së Votuesve, periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit fillon më 25 dhe përfundon më 27 janar 2021;
 - b) Periudha e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve fillon më 08 dhe përfundon më 16 janar 2021, deri në ora 18:00;
 - c) Afati për vendimmarrjen e KQZ-së për certifikimin e subjekteve politike përfundon më 22 janar 2021;
 - d) Periudha për paraqitjen e përmirësimeve/korrigjimeve nga subjektet politike fillon më 13 dhe përfundon më 17 janar 2021, në ora 18:00;
 - e) Afati për tërheqje të subjekteve politike fillon më 23 dhe përfundon më 31 janar 2021, në ora 18:00;
 - f) Data e mbajtjes së shortit për renditjen në fletëvotim dhe publikimi i subjekteve dhe kandidatëve është 01 shkurt 2021;

- g) Afati për caktimin e kufizimeve të shpenzimeve për fushatë fillon më 08 dhe mbaron më 12 janar 2021;
- h) Fushata zgjedhore si dhe afatet për tubimet zgjedhore fillojnë më 03 dhe përfundon më 12 shkurt 2021, në ora 23:59:59;
- i) Dorëzimi i kërkesës për akreditimin e vëzhgueseve të subjekteve politike dhe organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve fillon më 11 janar 2021 dhe përfundon më 05 shkurt 2021;
- j) Dorëzimi i kërkesës për akreditimin e vëzhgueseve ndërkombëtar dhe mediave për vëzhgimin e zgjedhjeve fillon më 11 janar 2021 dhe përfundon më 09 shkurt 2021;
- k) Emërimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve fillon më 11 dhe përfundon më 12 janar 2021;
- l) Publikimi i qendrave të votimit bëhet jo më vonë se 17 janar 2021;
- m) Aplikimi për regjistrim si votues jashtë Kosovës fillon më 13 janar dhe përfundon më 21 janar 2021, deri në ora 18:00.
- n) Aplikimi për regjistrim për votuesit e ngujuar në shtëpi fillon 14 janar dhe përfundon më 18 janar 2021;
- o) Afati për regjistrimin për votuesit me lëvizje të kufizuara në ndonjë institucion dhe votuesve me rrethana të veçanta fillon më 25 dhe përfundon më 29 janar 2021;

III. Caktimi i afateve sipas nenit I të këtij vendimi, do të vlejë për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 14 shkurt 2021.

IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 7 janar 2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

